

SË SHPEJTI AKTIVITETI MË I MADH PËR TURIZMIN



**FUTURE
HOSPITALITY
FORUM**

Më 2 Tetor 2026, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) do të organizojë për herë të parë në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit (TKOB), Tiranë, ngjarjen kryesore të sektorit të mikpritjes: Future Hospitality Forum.

"Building Value, Connecting Brands", ky forum shërben si një platformë strategjike investimi dhe partneriteti që synon të shndërrohet në pikëreferimin e turizmit premium në Shqipëri. Eventu mbledh në një mjedis të vetëm zhvilluesit vendas të projekteve turistike, investitorët, institucionet publike, ekspertët e sektorit dhe markat më prestigjioze ndërkombëtare hoteliere me 4 dhe 5 yje.

Objektivat dhe Elementet Kryesore të Forumit:

- Lidhja Strategjike: Krijimi i urave të bashkëpunimit mes mundësive lokale dhe eksperiencës globale përmes takimeve të drejtpërdrejta B2B.
- Prezantimi i Projekteve: Promovimi i projekteve konkrete turistike shqiptare, të gatshme për investim.
- Rritja e Standardeve: Nxitja e pranisë së markave globale në Shqipëri për të ngritur standardet e akomodimit dhe për të forcuar pozicionin e vendit si një destinacion konkurrues e i qëndrueshëm për investime elitare.

02TETOR
2026**TKOB, TIRANË****09:00 – 16:00**

ZONA BREGDETARE | Future Hospitality Forum

Aty ku bregdeti i Shqipërisë bëhet destinacioni i radhës për investime.

Kjo zonë e Future Hospitality Forum fokusohet në resorte bregdetare dhe zhvillime të integruara turistike në destinacionet me potencial të lartë, duke krijuar një hapësirë dialogu me marka ndërkombëtare të hotelierisë.

Zhvillues shqiptarë do të prezantojnë zhvillimet e tyre turistike bregdetare dhe planet e ardhshme përpara përfaqësuesve të markave ndërkombëtare hoteliere. Diskutimet do të fokusohen në mundësitë konkrete të bashkëpunimit, përshtatjen e projekteve me kërkesat e markave, si dhe në modelet e menaxhimit dhe zhvillimit të projekteve të reja.

Markat ndërkombëtare do të ndajnë përvojën e tyre mbi konceptet, modelet e operimit, standardet e zhvillimit dhe kriteret që marrin në konsideratë për përfshirjen në projekte të reja.

Takime të organizuara paraprakisht do të mundësojnë diskutime të drejtpërdrejta mbi projekte konkrete dhe mundësi të ardhshme bashkëpunimi.



COASTAL ZONE

ZONA URBANE | Future Hospitality Forum

Aty ku qytetet e Shqipërisë krijojnë mundësi të reja për zhvillim dhe investime.

Kjo zonë e Future Hospitality Forum fokusohet në zhvillimet urbane të hotelierisë, projektet mixed-use dhe transformimin e qendrave urbane në destinacione moderne për biznes, turizëm dhe investime.

Zhvillues shqiptarë do të prezantojnë projektet e tyre urbane, konceptet e reja të mikpritjes dhe planet e zhvillimit përpara përfaqësuesve të markave ndërkombëtare hoteliere.

Markat ndërkombëtare do të ndajnë ekspertizën e tyre mbi tendencat e reja të hotelierisë urbane, konceptet e dizajnit, modelet e operimit dhe kriteret strategjike për zhvillimin e projekteve të reja në qendrat urbane.

Takime të strukturuar B2B do të krijojnë mundësi për dialog të drejtpërdrejtë ndërmjet zhvilluesve, investitorëve dhe operatorëve ndërkombëtarë, duke nxitur bashkëpunime konkrete për të ardhmen e hotelierisë urbane në Shqipëri.



URBAN ZONE

ZONA E MALEVE DHE NATYRËS | Future Hospitality Forum

Aty ku peizazhet alpine dhe majat e maleve të Shqipërisë hapin horizonte të reja për luksin e qëndrueshëm dhe turizmin e aventurës.

Kjo zonë e specializuar e Future Hospitality Forum fokusohet në eko-hotele, bujtina elegante dhe resorte malore—duke i shndërruar zonat malore në qendra të nivelit botëror dhe të qëndrueshme për investime autentike dhe turizëm elitë.

Kompanitë shqiptare do të prezantojnë projektet e bazuara në natyrë, masterplanet e resorteve malore dhe zhvillimet ekologjike drejtpërdrejt te operatorët globalë të hoteleve.

Liderët globalë në turizmin ekologjik do të ndajnë vizionet më të fundit mbi trendet e eko-dizajnit, ekselencën operationale dhe kriteret strategjike për t'u zgjeruar në tregjet natyrore në zhvillim.

Future Hospitality Forum do të sjellë sesione të strukturuar rrjetëzimi B2B të projektuara për të nxitur dialogun direkt mes zhvilluesve, investitorëve dhe operatorëve ndërkombëtarë—duke e kthyer vizionin në bashkëpunime konkrete.



MOUNTAIN & NATURE ZONE

AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: HEDGE-IoT Open Call 2 – IoT-enabled Data-Driven Energy Services

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: HEDGE-IoT Open Call 2 – IoT-enabled Data-Driven Energy Services

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitioni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/title-hedge-iot-open-call-2-iot-enabled-data-driven-energy-services>



Platforma EXPORT ALBANIA

Platforma EXPORT ALBANIA është instrumenti mundësues i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) dhe me German Agency for International Cooperation (GIZ), për të fuqizuar bizneset shqiptare në ekspozimin dhe hyrjen në tregje globale.

Kjo platformë u konceptua si një zgjidhje strategjike për të mbështetur ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme duke ofruar:

1. Trajnime të specializuara për standardet e BE-së dhe analizat e tregut;
2. Rregullore të përditësuara doganore;
3. Raporte analitike mbi tendencat e tregjeve;
4. Aksesueshmëri në panaire ndërkombëtare;
5. Rrjetëzim me kompani ndërkombëtare në platformën “Kompas”;;
6. Krijimin e profileve të kompanive në platformë për prezantimin dhe promovimin e tyre EXPORT ALBANIA.

Nëse synoni të zgjeroni biznesin tuaj në tregjet ndërkombëtare krijoni llogarinë tuaj duke vizituar faqen <https://exportalbania.al>.

Për më shumë informacion:

Email: info@exportalbania.gov.al

Telefon: +355 4 225 1001


AIDA nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me FINEST S.p.A

Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), znj. Laura Saro, gjatë muajit korrik nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me shoqërinë financiare italiane FINEST S.p.A., të përfaqësuar nga Presidenti i saj, z. Luca Di Benedetto.

Ndër fushat kryesore të bashkëpunimit parashikohen: shkëmbimi i informacionit ekonomik e tregtar, promovimi i mundësive të biznesit, informimi për panaire e takime biznesi, si dhe forcimi i marrëdhënieve mes komuniteteve të biznesit në Shqipëri dhe rajonet e Italisë Veriore.

Gjatë takimit, në praninë e përfaqësuesve të FINEST S.P.A dhe Ambasadës Italiane në Shqipëri, u diskutua mbi rritjen e ndërveprimit ekonomik dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ky bashkëpunim forcon edhe më tej partneritetin ekonomik historik mes Shqipërisë dhe Italisë!



www.exportalbania.al



Tryezë e rrumbullakët me kompanitë e sektorit të Logjistikës dhe Transportit

Në 23 Korrik, në ambientet e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), u organizua tryeza e rrumbullakët me kompanitë që operojnë në sektorin e logjistikës dhe transportit. Kjo tryezë e rrumbullakët bëri bashkë Zv. Ministrin e Ministrisë së Ekonomisë, dhe Inovacionit Z. Enkelejd Musabelliu, Zv.Ministrin e Financave Z.Endrit Yzeiraj, Drejtoreshën e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve Znj. Laura Saro, Zëvendës Drejtorin e Autoritetit Portual Durrës Z. Andrea Shllaku, si dhe një sërë përfaqësuesish nga kompanitë më të mëdha që operojnë në vend si: Milsped, Sky Net, IFT-Move, Nexus Park Albania, TRANSALBANIA, Caushi Trans, Gebruder Weiss.

Gjatë tryezës, sektori i logjistikës u identifikua si një sektor me potencial për zhvillime të mëtejshme, duke luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e sektorëve të tjerë dhe në tërheqjen e investimeve. Në këtë kontekst, u diskutua edhe rëndësia e përmirësimit të infrastrukturës detare dhe rrugore, me synimin për të forcuar rolin e Shqipërisë si një nyje rajonale logjistike.

Kompanitë pjesëmarrëse shprehën interes për sigurimin e një fuqie punëtore të kualifikuar, përmirësimin e disa aspekteve procedurale, veçanërisht në lidhje me procedurat administrative, si dhe integrimin e teknologjisë në zinxhirin e furnizimit. Këto çështje u evidentuan si elemente të rëndësishme për rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së sektorit.

AIDA do të ndjekë në vijim adresimin e propozimeve të ngritura dhe do të organizojë takime me institucionet respektive për të diskutuar mbi këto çështje.



Fushata kombëtare "AIDA, AIC dhe Bashkitë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC), në bashkëpunim me bashkitë e vendit, po nisin një fushatë të re kombëtare që do të shtrihet në 10 qytete.

Përmes sesioneve informative, bizneset lokale do të njihen nga afër me mundësitë e financimit, standardet e BE-së, promovimin e eksporteve, lehtësirat fiskale e partneritetet strategjike si dhe transformimin urban të aseteve publike për një akses më të mirë në shërbimet publike.

Fushata synon një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe urban në komunitetet lokale duke i sjellë shërbimet dhe instrumentet e zhvillimit drejtpërdrejt te sipërmarrjet vendase.

Nga qyteti në qytet, nga informacioni te mundësia — qëndroni të lidhur për të mësuar datën dhe vendndodhjen e takimit në qytetin tuaj!

AIDA X AIC BASHKITË



AIDA në Frankfurt në zbatim të programit RECONOMY

Në zbatim të programit RECONOMY, Frankfurti mirëpriti një aktivitet biznesi ku Shqipëria dhe vendet e Ballkanit Perëndimor u prezantuan përpara kompanive gjermane si destinacione konkurruese për investime në sektorin e shërbimeve të biznesit, outsourcing dhe nearshoring.

Në aktivitet ishin pjesëmarrës përfaqësues të kompanive gjermane të interesuara për zgjerimin e aktivitetit të tyre në vendet e WB6, që u njohën me potencialin e rajonit.

Gjatë aktivitetit, AIDA prezantoi potencialin e Shqipërisë si një destinacion tërheqës për investime në sektorin e shërbimeve të biznesit, duke vënë në pah kapitalin njerëzor të kualifikuar, klimën e favorshme të biznesit dhe pozicionin strategjik të vendit për kompanitë që synojnë tregun evropian.

Aktiviteti u përmbyll me takime B2B me përfaqësuesit e kompanive gjermane. Nëpërmjet këtyre takimeve, AIDA zhvilloi fazën e parë të fushatës së saj outreach për sektorin e shërbimeve të biznesit, duke krijuar kontakte të drejtpërdrejta me kompani gjermane dhe duke promovuar Shqipërinë si një destinacion me potencial të lartë për investime në këtë industri.



AIDA dhe SIPPO Albania vizituan kompaninë prestigjioze zvicerane "ISA bodywear"

AIDA dhe SIPPO Albania vijojnë të lidhin kompanitë shqiptare me partnerë ndërkombëtarë.

AIDA, në bashkëpunim me SIPPO Albania, mbështeti kompaninë prestigjioze zvicerane "ISA bodywear", një prej prodhuesve më të njohur të veshjeve cilësore të brendshme, e themeluar në vitin 1849, për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit me sektorin shqiptar të prodhimit tekstil.

Në kuadër të kësaj iniciative, në datat 15 dhe 16 Korrik, ekspertët e AIDA-s dhe SIPPO Albania ofruan informacion të detajuar mbi tregun shqiptar, potencialin e sektorit dhe kapacitetet prodhuese të kompanive vendase. Gjithashtu, u organizuan takime B2B dhe vizita në kompani prodhuese në Durrës, Shkodër dhe Berat, me synim njohjen nga afër të aftësive dhe eksperiencës së industrisë shqiptare të tekstitil dhe identifikimin e mundësive konkrete për bashkëpunim.

Përmes këtij shërbimi të mbështetur nga AIDA dhe SIPPO Albania, "ISA bodywear" pritet të identifikojë partnerë të përshtatshëm prodhues në Shqipëri dhe të zgjerojë bashkëpunimin e saj me industrinë vendase gjatë këtij viti.



AIDA në tryezën e rrumbullakët për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit të vajit të ullirit në Belsh

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në tryezën e rrumbullakët: "Për forcimin e qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së sektorit të vajit të ullirit" e cila u zhvillua në Belsh. Ky aktivitet i organizuar nga UNDP Shqipëri dhe FAO, mbledhi së bashku fermerë, prodhues, institucione qeveritare dhe partnerë ndërkombëtarë për të diskutuar mbi masa praktike për zhvillimin e këtij sektori strategjik.

Fokusimi i diskutimeve ishte sigurimi i cilësisë, certifikimi për prodhimin e vajit ekstra të virgjër me standard eksporti si dhe modernizimi i proceseve të vjeljes, përpunimit dhe rritje e investimeve. Në këtë tryezë bashkëpunimi morën pjesë aktorë të rëndësishëm si Ambasada e Suedisë, Ministria e Bujqësisë, AZHBR, UNIDO, Bashkia Belsh, shoqatat e prodhuesve dhe institucione financiare.

AIDA mbetet e përkushtuar në mbështetjen e bizneseve vendase dhe promovimin e potencialeve tona në tregjet ndërkombëtare!



AIDA merr pjesë në hapjen e edicionit të dytë të programit EWA 2026

Më 6 korrik 2026, në Europe House, Tiranë, u zhvillua aktiviteti "EWA 2026 – Kick Off & Matchmaking", që shënoi hapjen e edicionit të dytë të programit EWA në Shqipëri. Programi EWA – Empowering Women in Agrifood zbatohet në Shqipëri nga Qendra Balance, si pjesë e nismës së EIT Food për zhvillimin e sipërmarrjes së grave në sektorin agrourbues.

Në këtë aktivitet AIDA u përfaqësua nga znj. Fiona Beqiri, Drejtore e Projekteve, NMV-ve dhe Eksporteve, e cila prezantoi instrumentet mbështetëse që AIDA ofron për zhvillimin e ndërmarrjeve, inovacionin dhe sipërmarrjen në sektorin agrourbues.

AIDA shpreh vlerësimin për të gjitha gratë sipërmarrëse që po ndërtojnë ide, biznese dhe modele të reja suksesi, duke i inkurajuar të vazhdojnë të investojnë në vizionin, guximin dhe potencialin e tyre për të krijuar ndikim të qëndrueshëm në ekonomi dhe shoqëri.



Vizitë Aftercare pranë TÜV AUSTRIA Albania & Kosovo

Përfaqësues nga AIDA zhvilluan një vizitë Aftercare pranë TÜV AUSTRIA Albania & Kosovo, ku u diskutua mbi rolin e certifikimit dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare në rritjen e konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve në rajon. Së bashku konsoliduam ide mbi fusha me interes kritik sot – si siguria kibernetike, energjia e rinovueshme, cilësia në turizëm dhe përgatitja e produkteve vendase për tregjet e eksportit.

Përfaqësuesit e TÜV AUSTRIA ndanë me ne sfidat kryesore që hasin bizneset gjatë operimit në tregun e Shqipërisë dhe Kosovës.

AIDA mbetet e përkushtuar për të mbështetur sipërmarrjet në kapërcimin e këtyre sfidave, duke nxitur një ambient biznesi më të sigurt dhe plotësisht të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare.




AIDA merr pjesë në lançimin e Programit Kombëtar “Dyfisho Sipërmarrjen Tënde”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në lançimin e Programit Kombëtar “Dyfisho Sipërmarrjen Tënde”, një nismë e re e Qeverisë Shqiptare që synon të zgjerojë aksesin e sipërmarrjeve dhe fermerëve në financim për investime dhe zhvillim.

Programi krijon mundësi të reja financimi për sipërmarrjet shqiptare përmes kredive me kushte të favorshme, garancisë sovrane dhe mbështetjes për investime në teknologji, prodhim, bujqësi, turizëm, energji dhe inovacion, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare.

AIDA mbetet e angazhuar në mbështetjen e sipërmarrjes shqiptare dhe në promovimin e instrumenteve që lehtësojnë investimet, rrisin konkurrueshmërinë e bizneseve dhe nxisin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.



MOS 2026, Ngjarja më e madhe e biznesit në Slloveni | 16-20 Shtator

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) gjatë muajit Korrik vijoi me fushatën promovuese dhe ftesën për shprehje interesi drejtuar sipërmarrësve vendas për t'u bërë pjesë e Pavijonit Kombëtar Shqiptar në panairin ndërkombëtar të biznesit dhe tregtisë MOS 2026, i cili do të zhvillohet në Celje, Slloveni. Ky është panairi më i madh i biznesit dhe tregtisë në Evropën Qendrore dhe Juglindore, MOS 2026 - mundësi ndërkombëtarizimi për biznesin shqiptar

Si ngjarja më e madhe tregtare, MOS 2026 mbledh mbi 650 ekspozues nga më shumë se 20 shtete dhe mirëpret mbi 50,000 vizitorë profesionistë gjatë 5 ditëve të aktivitetit.

Në bashkëpunim me SPIRIT Slovenia dhe ISR, AIDA do të organizojë një aktivitet të dedikuar për sektorin e përpunimit të drurit. Ky aktivitet i rëndësishëm do të zhvillohet në dt. 17 Shtator 2026, i cili do të ketë në fokus zhvillimin e takimeve B2B, krijimin e kontakteve direkte dhe tërheqjen e investitorëve potencialë për këtë industri.

Pjesëmarrja u ofron bizneseve shqiptare një platformë konkrete për ndërkombëtarizimin e markës së tyre, promovimin e kapaciteteve përballë blerësve e distributorëve evropianë, si dhe njohjen me trendet më të fundit të tregut ndërkombëtar.

 16-17 Shtator 2026
 Celjski sejem, Slloveni

 Kontaktoni AIDA për detaje mbi procedurën e aplikimit.

AIDA falënderon të gjithë sipërmarrësit, përfaqësuesit e bizneseve dhe subjektet e interesuara për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre aktiv në këtë cikël informues. Agjencia mbetet e përkushtuar të vijojë mbështetjen për sipërmarrjen shqiptare, duke ofruar mundësi konkrete për zhvillim, konkurrueshmëri dhe rritje të qëndrueshme.

Publikimet e përditësuara të AIDA-s

Broshura "Soft Landing": Guida juaj praktike për të investuar në Shqipëri

Po kërkon të investoni në Shqipëri ose të zgjeroni biznesin tuaj? AIDA ka përgatitur udhërrëfyesin e duhur me të dhënat më të fundit të tregut!

Broshura "Soft Landing" vjen si një guidë praktike për investitorët e huaj dhe vendas që dëshirojnë të nisin aktivitetin e tyre me lehtësi dhe efikasitet të plotë.

Kjo guidë praktike është pasuruar me të dhënat më të fundit ligjore, fiskale dhe procedurale, duke u ofruar investitorëve vendas dhe të huaj një pasqyrë të qartë mbi tregun shqiptar. Nga regjistrimi online i biznesit dhe lejet unike, e deri te mundësitë në techno-parqe dhe menaxhimi i burimeve njerëzore – gjithçka që ju nevojitet për një fillim të mbarë ndodhet këtu.

Shkarkoni versionin e ri në faqen tonë zyrtare <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/07/One-Page-SOFT-LANDING.pdf>



Broshura e përditësuar "Albanian Calls"

Ky botim vjen si një udhërrëfyes i detajuar mbi avantazhet tona konkurruese, klimën pozitive të biznesit dhe historitë e suksesit që po formësojnë të ardhmen ekonomike të vendit.

Zbuloni potencialin e plotë të tregut shqiptar dhe bëhuni pjesë e historisë sonë të suksesit!

Shkarkoni broshurën e plotë në faqen tonë zyrtare https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/07/AIDA_Albania_Calls_2026.pdf



AIDA ju fton të merrni pjesë në: Panairin Ndërkombëtar të Selanikut (TIF) | 5-13 Shtator 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë vendase të bëhen pjesë e Edicionit të 90-të të TIF 2026, i cili do të zhvillohet në datat 5-13 shtator 2026 në Selanik, Greqi.

TIF (Thessaloniki International Fair) është një nga platformat më të rëndësishme tregtare në Evropën Juglindore. Ky edicion është jubilar (100-vjetori i TIF-HELEXPO) dhe Shqipëria është ftuar zyrtarisht të prezantojë potencialin e saj ekonomik, tregtar, turistik e kulturor në seksionin ndërkombëtar "COSMOS".

Pse duhet të merrni pjesë?

- Promovoni produktet dhe shërbimet tuaja në tregjet ndërkombëtare.
- Krijoni partneritete të reja dhe kontakte direkte biznesi.
- Tërhiqni investitorë të huaj.

 Selanik, Greqi
 5-13 Shtator 2026

Të gjithë bizneset e interesuara mund të plotësojnë formularin e aplikimit në këtë link:
<https://www.thessalonikifair.gr/en/Exhibitor-expression-of-interest-form>

